



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Ligji “Regjistrimi i Pronarëve Përfitues”

Sesion Informimi

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri zbatohet në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri



Çështjet Kryesore të Sesionit

1. Identifikimi i Pronarit
2. Procedura e Aplikimit për Regjistrimin
3. Dokumentet e Nevojshme
4. Nënshkrimi Elektronik
5. Afatet

Identifikimi i Pronarit Përfitues

Pronar Përfitues

Individi i cili ka në pronësi ose kontrollon I fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të një përqindje të mjaftueshme **të aksioneve ose të drejtave të votimit** ose të pjesëmarrjes në kapitalin e atij entiteti, përfshirë përmes mbajtjes së aksioneve, ose përmes **kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera**, ose që përfiton nga transaksionet e kryera nga personi juridik në emër të tij.

Themeluesi ose përfituesi ligjor ose individi që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e **organizatave jofitimprurëse**.

Krijuesi i trust-it, kujdestari/i mirëbesuari, mbrojtësi, nëse ka, dhe përfituesi ose kur personat që përfitojnë nga marrëveshja ligjore ose entiteti ende nuk janë përcaktuar, klasa e personave për interesin kryesor të të cilëve marrëveshja ligjore ose entiteti është krijuar ose operon; çdo individ tjetër që ushtron kontrollin e fundit mbi trustin me anë të pronësisë direkte ose indirekte ose me mjete të tjera.


Identifikimi i Pronarit Përfitues

Individi me pozicion drejtues

Identifikohet dhe regjistrohet si pronar përfitues individi që mban pozicionin e drejtuesit/drejtuesve më të lartë të subjektit raportues.

Depozitohet:

- Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues;
- Dokumentacion që vërteton pozicionin e individit të regjistruar si pronar përfitues, në pozicionin përkatës.



Pronari i 25%+

Pronësi direkte ose indirekte e 25% ose më shumë të kapitalit, të drejtës së votës ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera.

Personi që përcakton vendimet

- Përcakton vendimet e marra nga një person juridik;
- Kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive

Depozitohet:

- Deklaratë nga përfaqësuesi ligjor;
- Dokumentacion që vërteton kontrollin

Të dhënat në Regjistrimin e Pronarëve Përfitues



Për Subjektin raportues:

- NUIS
- Emri I subjektit raportues



Për personin Përfitues:

- Të dhënat e identifikimit;
- Data e përcaktimit të individit si Pronar Përfitues;
- Lloji dhe përqindja e pronësisë.



Të dhënat të regjistruara në Regjistër:

- Emri dhe Mbiemri I Pronarit Përfitues;
- Shtetësia;
- Viti dhe muaji i lindjes;
- Data e përcaktimit të individit si pronar përfitues;



- Çdo person i interesuar ka të drejtë të marrë pa pagesa, ekstrakte elektronike për të dhënat që janë publike për pronarët përfitues.

Dokumentacioni Shoqërues

- Dokumentacion që vërteton NUIS dhe emrin e subjektit raportues
- Dokumentacionin që vërteton të dhënat e identifikimit të pronarit përfitues
- Dokumentacionin e regjistruarit që vërteton se pronari përfitues është zotërues i 25% I kapitalit/votave
- Dokumentacion tjetër që përmban informacionin e nevojshëm për identifikimin e pronarit përfitues.



Subjektet raportuese kanë **detyrimin** të ruajnë dhe të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese **të duhura, të sakta e të përditësuara.**

Pronarët përfitues të subjekteve raportuese kanë **detyrimin** t'u japin subjekteve raportuese të gjithë **informacionin e nevojshëm.**

Procedura e Aplikimit për Regjistrimin

HAPAT



1

Personi I autorizuar pajiset me nënshkrimin elektronik

2

Identifikimi I Pronarit Përfitues sipas parashikimeve të Ligjit

3

Sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm

4

Plotësimi I formularit në e-Albania dhe depozitimi I dokumentacionit brenda afatit

5

Pranimi I aplikimit dhe Reflektimi I të dhënave në Regjistër

Nnëshkrimi Elektronik



- Aplikimi on-line nëpërmjet portalit e- Albania



Procedura zgjat rreth 3 ditë pune



- Formulari I aplikimit për regjistrimin duhet të nënshkruhet elektronik të personit të autorizuar



- Proces I domosdoshëm për realizimin certifikimit të të dhënave

Afati I Regjistrimit



Krijimi I Regjistrimit të Pronarëve
Përfitues



Subjekte Raportuese Ekzistuese

Afat **60 ditë** nga themelimi I Regjistrimit të
Pronarëve Përfitues



Subjektet e Krijuara Rishtazi

Afat **30 ditë** nga themelimi i tyre



Përfundimi I Afatit për Regjistrimin

Pyetjet më të shpeshta

Pyetje: Per organizatat jofitimprurese qe kane kaluar ne Status Pasiv a aplikohet ligji?

Përgjigje: Detyrimi i regjistrimit të pronarit përfitues, e ka cdo subjekt raportues, pavarësisht statusit të tij.

Pyetje: Kush mund te regjistrohet si pronar i OJF-s?

Përgjigje: Pronar përfitues i organizatave jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse, është:

- Themeluesi ose
- përfaqësuesi ligjor ose
- individi që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia në të cilën një person:
- përcakton vendimet e marra nga organizata jofitimprurëse;
- kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të organizatës jofitimprurëse

Pyetjet më të shpeshta

Pyetje: Formulari i aplikimit është i njejte për të gjitha subjektet raportuese. Termat pronar, pronesi direkte/indirekte, kuota etj. nuk korrespondojnë me natyrën juridike të OJF. Kjo krijon problem gjatë plotësimit të aplikimit për këto subjekte, i cili nuk validohet lehtësisht

Përgjigje: Referuar natyrës së ndryshme të një OJF-ve nga subjektet tregtare dhe identifikimit të pronarit të tyre përfitues i cili sipas ligjit është i ndryshëm; formularët e aplikimit janë hartuar në dy lloje: për OJF dhe subjekte tregtare.

Pyetje: Cfare nenkupton deklarata me shkrim e themeluesit të OJF ose presidentit, kur pozicioni i tij është i mirepërcaktuar në statutin e vete shoqates?

Përgjigje: Referuar VKM nr. 1088/2020, deklarata me shkrim e përfaqësuesit ngarkohet në rast se pas shterrimit të të gjitha mjeteve të mundshme për identifikimin e pronarit përfitues dhe nëse nuk ka arsye për dyshime, subjektet raportuese nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues sipas përcaktimeve të ligjit “Për regjistrin e pronarëve përfitues”. Pra, është një akt që nuk përcakton pozicionin e tij në subjektin raportues, por hapat që ai ndërmerr për identifikimin e pronarit përfitues si dhe arsyet e identifikimit të personit të regjistruar si pronar përfitues.